Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhëne në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS⁴

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

⁴ Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e ofertes ;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- e. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 8/1;*
- f. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- g. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- h. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- i. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit ushtrimore (2017,2018,2019), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.
 2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2017,2018,2019)lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet të jete jo me vogel se vlera e fondit limit
 3. Vërtetim lëshuar nga Bashkia për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019, 2020.
- 3.1** Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR.

Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit .
- b. punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me:
 - . Kontrate dhe
 - . Situacionet pjesore ose situacionin përfundimtar; dhe
 - . Aktin e kolaudimit dhe
 - . Certifikaten e marrjes ne dorezim te objektit

Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtem:

- . Kontrate dhe
 - . Situacionet pjesore ose situacionin përfundimtar; dhe
 - . Akt kolaudimi objekti; dhe
 - . Certifikaten e marrjes ne dorezim te objektit dhe
 - . Fatura tatimore për çdo situacion punimesh OSE për situacionin përfundimtar.
- Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

2. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

- a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhte:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

1. NP – 1 B (Punime gjurmimi në tokë).
2. N.P – 2 A (Ndërtime Civile dhe industriale)
3. N.P– 5 B(Punime nentokesore, ura e vepra arti)
4. N.P – 7 D (Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje)
5. N.P – 12 D (Punime të Inxhinierisë së Mjedisit)

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

1. N.S.-2 A (Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre)
2. NS-4 A(Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to,rifiniture me materjale druri,plastik,metalik,dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese.
3. N.S. – 8 A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
4. N.S. – 9 A Punime strukturorë speciale.
5. N.S. – 16 B Ndërtimi i impianteve të ujit të pishëm dhe pastrimit të tij.
6. N.S. – 18 A Punime topogjeodezike

sipas modelit të lëshuar nga MPPT;

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

3.Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt me eksperience minimumi 10 (dhjete) vjecare të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. Libreze pune (perkatëse)
- ii. CV perkatëse
- iii. Kontrate pune të vlefshme (përkatëse)
- iv. Diplome

4. Një punësim mesatar i të paktën 80(tetëdhjete) personave, për periudhën Shkurt 2020- Shkurt 2021 të vërtetuar me;

4.1 Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën **Shkurt 2020- Shkurt 2021**

4.2 Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Shkurt 2020- Shkurt 2021** sipas formatit E-Sig 025/a,

4.3 Formularët e deklaratimit të pagesave për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat shoqëruar me mandatë pagesat e bankës.

5. Shoqëria të ketë në licencën e shoqërisë drejtues teknik minimumi:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) inxhinier Gjeodet
- 1 (një) inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) inxhinier Mekanik
- 1 (një) inxhinier Mjedisi

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin diplomat, kontratat e punës dhe CV përkatëse, librezat e punës si dhe të rezultojnë në listë pagesa për periudhën **Shkurt 2020- Shkurt 2021**

5.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, të paraqiten kontrata e punës dhe diplomat/ deftesat përkatëse, librezat e punës.

5.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të paktën një drejtues teknik të shoqërisë që të disponojë dëshmi trajnimit si ” **Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 ”Për miratimin e rregullores ”Për sigurinë në kantier”. Për drejtuesin teknik të shoqërisë duhet të paraqitet **certifikata e trajnimit për ”Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** e dhëna nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës, i cili duhet të jetë i përfshirë në listëpagesa për periudhën **Shkurt 2020- Shkurt 2021**

5.5 Mbështetur në:

Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta, Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 PER DISA NDRYSHIME NE LEGJISLACIONIN NE FUQI PER LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Kreu II Neni 9 Detyrime te krijuesit te mbetjeve

Neni 12 Perpunimi dhe asgjesimi i mbetjeve te ndertimit

Neni 24/1

Neni 25 Lejet mjedisore

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B.

5.5 Operatori ekonomik përveç drejtuesve teknik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e vetë punonjës me profesionet si më poshtë:

- jo më pak se 2 (dy) teknik ndertimi
- jo më pak se 2 (dy) punonjës elektrikist
- jo më pak se 2 (dy) punonjës hidraulik
- jo më pak se 1 (një) punonjës saldator
- jo më pak se 1 (një) punonjës mekanik
- jo më pak se 2 (dy) punonjës bojaxhi
- jo më pak se 2 (dy) punonjës pllakashtrues
- jo më pak se 1 (një) karpentier
- jo më pak se 5 (pese) specialist për montim tubash
- jo më pak se 2 (dy) punonjës shofera
- jo më pak se 1 (një) inxhinier hidroteknik
- jo më pak se 1 (një) inxhinier ndertimi profili transport (Për Punime në rrugë)
- jo më pak se 1 (një) punonjës teknik Gjeometër ose topograf

Për punonjësit e mesiperm, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: kontratën individuale të punës, kartelat personale të sigurimit teknik të leshuara nga një organ i akredituar certifikues personeli (Grup Certifikues) në bazë të **Ligjit nr.8734 datë 01.02.2001 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike”**, i ndryshuar dhe të **VKM-së nr.42, date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”**, i ndryshuar, si dhe të figurojnë në të gjithë listë pagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit. (Dhjetor 2020-

Shkurt 2021) **Per punonjesit teknik ndertimi, inxhinier hidroteknik, inxhinier ndertimi profili transport** duhet te paraqitet edhe dokumenti qe verteton kualifikimin (deftese dhe/ose diplome).

5.6 Per gjithë drejtuesit e makinerive te renda , sipas Urdher Nr.44, datë 4.2.2004 “Per miratimin e rregullores “Per Procedurat dhe kriteret per dhenien e lejeve te manovrimit perdoruesve te makinerive te renda te ndertimit dhe disiplinimi i perdorimit te makinerive te ndertimit” Dëshmi te aftesise profesionale ose leje manovrimi te vlefshme leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktures te vlefshme, minimumi 1 automakinist, 2 eskavatorist , 1 buldozerist, te shoqeruar me kontratat e punes dhe të figurojne ne listpagesat te pakten 3 muajt e fundit(Dhjetor 2020-Shkurt 2021).
(Ne rastin kur mjetet jane me qira te kene kontrate te vlefshme pune)

6.Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise,ose standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

1. Shoqeria duhet te paraqesë Certifikate te cilesise se punimeve **ISO 9001- 2015(Sistemi i menaxhimit të Cilësisë).**
2. Shoqeria duhet te paraqesë Certifikate ISO 14001:2015 (**Sistemi i menaxhimit Mjedisor).**
3. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **OHSAS 18001-2007(Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)** ose ekuivalent ISO 45001:2018
4. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **PAS 99-2012 (Sistemi i Menaxhimit të Integruar)**
5. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO 39001 -2012 (per sigurine e menaxhimit te trafikut)**

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme, sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër në aktmarrëveshjen e bashkëpunimit.Certifikatat duhet te jene te vlefshme.

1. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9)

<i>3. Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamioncine 1-1.5 ton	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
Kamioncine 3.5- 5 ton	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
Kamion 13-20 ton	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
Kamion me vinç	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
Rimorkiator per levizjen e mjeteve	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobot uji 5000 L</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autovinc</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

Dokumenta Standarde të Tenderit

<i>Fadrome</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Eskavator me goma</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Eskavator me zinxhir</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
Rul me kompresor	<i>1cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Trapan elektrik</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Matrapik</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Betonforma</i>	<i>800m2</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Paisje per ngjitje plastike</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibrator betoni</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Ngjeshes vibrues</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Betoniere</i>	<i>8 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Karoca dore</i>	<i>10 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Motogjenerator</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pompe suvatimi</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Saldatrice</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Nivelues betoni (helikopter)</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Total station dhe/ ose GPS</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Tronket per hapje kanalesh mbi 10 ton</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pipe Laser KL-81L (Paisje per shtrim tubi me pjerresi te detyruar, distanca maksimale eshtrimit me nje stacion lazeri deri ne 500 m, pjerresi – 10 deri ne +40%)</i>	<i>2cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pompe uji</i>	<i>2cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kompresor ajri</i>	<i>1cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Çekic pneumatik per thyerjen e betoneve dhe shkembinjve</i>	<i>1cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Aparat Saldimi per tuba çeliku</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Aparature bashkimi ne nyje dhe ne zona te vecanta me “Elektrofusion</i>	<i>2cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rul me kompresor</i>	<i>1cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Paisje per matjen e presionit te tubave</i>	<i>1cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)</i>	<i>1cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Aparature per testimin e ngjeshmerise se materialit me metode me goditje (pjate)</i>	<i>1cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Paisje per testimin e saldimit(deflektometer)</i>	<i>1cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Aparat meger 2500v-5000v</i>	<i>1cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 50 cope
- Rripa lidhes sigurimi per punime ne lartesi minimumi 5 cope
- Fikse zjarri te levizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 cope
- Prozhektore ndricimi naten minimumi 4 cope
- Komplet i ndihmes se shpejte minimumi 5 cope
- Tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt minimumi 20 cope

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- b) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- c) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).*
- d) *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar **me kontratë pune të vlefshme**, Liçense per ushtrimin individual te profesionit, diplomë.(Në mbështetje të VKM Nr. 632 date 15.07.2015”Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin Nr.108 date 09.02.2011,te Keshillit te Ministrave “Per aftesite qe duhet te plotesojne punemarresit,personat dhe sherbimet e specializuara,qe merren me ceshtjet e sigurise dhe shendetit ne pune” në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, **apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë**, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.(Ne rastin e bashkimit te operatoreve secili operator duhet të ketë mjekun)*

12.1 Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit ose test raporte ku te vertetoje perputhjen e plotë me specifikimet teknike te kerkuara **per te gjithë mallrat qe kane kontakt me ujin e pijshem**,objekt prokurimi: Mosparaqitja e te gjithë katalogeve per produktet e kerkuara ose paraqitja e katalogeve te cilet nuk vertetojne permbushjen e te gjithë specifikimeve teknike te kerkuara per mallrat e mesipermben kusht per skualifikim. (të përkthyer në shqip dhe te noterizuara).

12.2 Operatori/et ekonomik ofertues duhet te kete linje prodhimi ne pronesi/qera ose

autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar, ne perputhjen e plotë me specifikimet teknike te kerkuara **per te gjithë mallrat qe kane kontakt me ujin e pijshem**, objekt prokurimi. Ne rast paraqitje te autorizimit nga distributori, OE duhet te paraqese dokumentacionin per te vertetuar se subjekti ne fjale eshte distributor zyrtar. Autorizimi duhet te jete i leshuar brenda 3 viteve te fundit. *(të përkthyer në shqip dhe te noterizuara).*

12.3 Operatori/et ekonomik ofertues ne perputhjen e plotë me specifikimet teknike te kerkuara **per te gjitha mallrat qe kane kontakt me ujin e pijshem** objekt prokurimi, duhet të kenë certifikate të aprovimit për përdorimin per ujë të pijshëm (p.sh DVGW, WRAS ose ekujvalente me keto) nga të paktën 1 institucion kombetare, nderkombetare ose institucione te pavarura certifikuese/testuese. Operatoret ekonomike pjesmarres duhet te paraqesin keto certifikata te cilat duhet te jene te vlefshme. *(të përkthyer në shqip dhe te noterizuara).*

13 Operatori ekonomik duhet te kete kontrate noteriale me nje laborator testimi te betonit, i cili duhet te jete i akredituar nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12504-4:2008, SSH EN 12350-2:2009 dhe SSH EN 12504-2:2012.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin. (Fragmentet e katalogut/ve per listen e artikujve te mesiperm duhet te perkthehen ne gjuhen shqipe.)

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Dokumenta Standarde të Tenderit

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomike më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Dokumenta Standarde të Tenderit

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS **Punët – Procedura e Hapur**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha

Dokumenta Standarde të Tenderit

bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore

ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

16.2 Kontratori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

